



NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. PRISHTINË
GJP "AUTOBUSKA STANICA" A.D. PRISTINA
MPE "BUS STATION" J.S. PRISTINA

	NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH. A. GJP "AUTOBUSKA STANICA" A. D. MPE "BUS STATION" J. S.
Nr. <u>09/1338</u> No.	Data <u>14.08</u> 20 <u>19</u> Date
PRISHTINË/A	

REGULLORE KUNDËR PIRJES SË DUHANIT NË AMBIENTET E NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A.

Prishtinë, Prill 2019

N.P.L " Stacioni i Autobusëve"SH.A. - Prishtinë
Rr. Bill Clinton, p.n – Prishtinë/ Kosovë
+383 (38) 55 00 11
info@sap-rks.com
www.sap-rks.com;

Në harmoni me dispozitat dhe nenet e LIGJIT Nr. 04/L-156 PËR KONTROLLIN E DUHANIT, miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës e në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, secila Ndërmarrje Publike Lokale ka obligim që të nxjerr rregullore ose akt tjetër normative që ndalon pirjen e duhanit në ambientet e punës, zyra, korridore e depo të NPL. në pajtim me këtë ligj Bordi i Drejtorëve I NPL “Stacioni I Autobuseve” SH.A. ne takimin e mbajtur me date 5.04.2019 nxjerr RREGULLORE KUNDËR PIRJES SË DUHANIT NË AMBIENTET E NPL “STACIONI I AUTOBUSËVE” SH.A.

Neni 1

Qëllimi

- 1.1. Me synim të mbrojtjes së shëndetit publik, të gjeneratave të tanishme dhe të ardhshme nga pasojat shkatërruese shëndetësore, sociale, ekonomike e mjedisore të konsumimit të duhanit dhe ekspozimit ndaj tymit të duhanit, me këtë ligj përcaktohen masat për ndalimin, kufizimin e përdorimit të produkteve të duhanit, përbërësve të duhanit, parandalimin e pasojave të dëmshme nga përdorimi i produkteve të duhanit dhe mbikëqyrjen për zbatimin e Ligjit nr.04/L-156 për Kontrollin e Duhanit.
- 1.2. Për të arritur qëllimin e ligjit përcaktohen masa për të:
 - a. siguruar që të gjithë qytetarët janë të mbrojtur në mënyrë të barabartë dhe të efektshme nga ekspozimi i tymit të duhanit në hapësirat e mbyllura, të punës, hapësirat publike, lokacionet e hapura të veçanta dhe në mjetet e transportit publik,
 - b. ka për qëllim që të parandaloj dhe reduktoj pirjen e duhanit me përcaktimin e normave që rregullojnë ambient pa tym të duhanit;
 - c. të eliminoj nxitjet për pirjen e duhanit të cilat krijohen nga reklamimi, duke i ndaluar të gjitha reklamat, promovimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta;
 - d. ka për qëllim të informoj popullatën lidhur me rreziqet dhe dëmet specifike të përdorimit të produkteve të duhanit, pasojat e dëmshme shëndetësore, natyrën e varshmërisë, kërcënimet vdekjeprurëse që paraqet konsumimi i duhanit dhe ekspozimi ndaj tymit të duhanit;
 - e. jep këshilla kundër përdorimit të duhanit dhe inkurajon ndërprerjen e përdorimit të produkteve të duhanit nga përdoruesit;
 - f. ligji ka për synim ndalimin, qasjen e blerjen e produkteve të duhanit për të miturit;
 - g. të mbroj qytetarët nga dëmet e shkaktuara nga përdorimi i produkteve të duhanit;
 - h. promovon shëndetin dhe të drejtat e njeriut në përputhje me Konventën Kornizë për Kontrollë të Duhanit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Neni 2

Kompetencat

- 2.1. Në pajtim me mandatin që i është dhënë dhe konform Statutit të Kompanisë, Kryeshefi Ekzekutiv i NPL „Stacioni i Autobusëve“ Sh.A. me seli në Prishtinë, por edhe vetë Bordi i Drejtorëve, ka obligim që të nxjerr rregullore të brendshme që ndalon ekspozimin e pirjes së duhanit në vendet e ndaluara me këtë ligj. BD gjegjësisht Kryeshefi Ekzekutiv me datë

15.04.2019, miraton dhe aprovon këtë: Rregullore-mbi ndalimin e pirjes se duhanit në objektet e NPL-SAP „Stacioni i Autobusëve“ Sh.A. në Prishtinë. Kjo rregullore nxirret me qëllim të:

- 2.2. Mbrojtja nga ekspozimi ndaj tymit të duhanit duke ndaluar pirjen e duhanit në:
 - 2.2.1 hapësirat publike;
 - 2.2.2 zyrat, ambientet e punës;
 - 2.2.3 mjetet e transportit të NPL-së në pronësi të vetën;
 - 2.2.4 lokacionet e hapura të përcaktuara në paragrafet e kësaj rregulloreje si.
 - a. në objektin ndërtimor-ndërtesën e stacionit, asnjë person nuk lejohet të pijë duhan,
 - b. në hapësirat të përbashkët të ndërtesës, korridore, WC, sportele e në zyra,
 - c. Asnjë person nuk lejohet të pijë duhan në ndonjë hapësirë publike si holli para sporteleve,
 - d. Aty ku gravitojnë fëmijët, nxënësit dhe qytetarët e zakonshëm,
 - e. në afërsi të hyrjeve/daljeve të hapësirave publike,
 - f. hyrjeve/daljeve të hapësirës të punës.
 - g. Kryeshefi Ekzekutiv duhet të siguroj një ambient të veçant ku mund të pihet duhani, brenda në objekt por i mbrojtur nga ekspozimi i zyrave tjera ose jashtë objektit në vend të caktuar.

Neni 3

Fushëveprimi

Duke marr parasysh obligimet që dalin nga dispozitat dhe nenet e Ligjit Nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit, Ligjit mbi Sigurinë në punë, shëndetin dhe mjedisin e punës, me saktësisht neni 7 pika 7.2 i cili thekson „Në ambientet e mbyllura të punës, ku punojnë më shumë se një i punësuar ndalohet prirja e duhanit“. Duke pas parasysh pasojat e dëmshme që sjell duhani për shëndetin e njeriut sidomos konsumuesit pasiv të tij dhe mbrojtjen e ambienteve punëuse brenda objekteve të NP-së. Miratohet Rregullorja e cila ka për qëllim ndalimin e pirjes së duhanit brenda objekteve të Ndërmarrjes Publike Lokale „Stacioni i Autobusëve“ Sh.A., në Prishtinë, me qëllim të evitimit të pasojave të dëmshme që sjell duhani dhe për arsye të mirëmbajtjes së pastërtisë të ambienteve të punës në NPL „Stacioni i Autobusëve“. Neni 2 ndalon pirjen e duhanit nëpër të gjitha objektet, korridoret, zyrët, nyjet sanitare dhe WC-të, automjete nëse posedon ndërmarrja dhe vende të tjera brenda objektit të NPL „Stacioni i Autobusëve“ Sh.A., duke vendosur shënja të madhësisë 40 cm² në hollin e stacionit ose 30 cm² në zyra dhe ambiente tjera të vogla. Mbishkrimi ose cigarja e ndaluar me X, duhet të shkruhet edhe mbishkrimi në së paku tri gjuhë: ndalohet rreptsisht pirja e duhanit. Mbishkrimi duhet të jetë i ekspozuar apo vendosur në vend të dukshëm dhe aty ku mund të vështrohet lehtë me sy.

Neni 4

Përgjegjësitë

Për duhanpirësit duhet të çaktohet vendi i pirjes së duhanit një dhomë apo kthinë brenda ose jashtë objektit: së paku 10m² e cila mund të përdoret si vend ku ekskluzivisht pihet duhani në ndërmarrje.

Neni 5

Sankcionet

Të gjithë punëtorët të cilët kapen duke pirë duhan në zyrë ku ata punojnë apo vende të tjera të ndaluara të ndërmarrjes, si në nenin 2, do të denohen me vërejtje nëse zinet për here të pare, në rast se përsëritet vepra apo shkilet rregullorja atëherë do të aplikohet gjobë financiare e cila parashihet me ligj për personat fizik që shkelin ligjin. Në rastet kur vepra e shkeljes së ligjit përsëritet edhe përkundër aplikimit të gjobës dhe ndëshkimit financiar, atëherë në këto raste KE inicon zhvillimin e procedurës disiplinore kundër shkelësit.

Neni 6

Parandalimi

Me qëllim të zbatimit rigoroz të kësaj Rregullore obligohen të gjithë personat të cilët vërejnë njërez të cilët pijnë duhan brenda objektit të kësaj Kompanie t'a lajmërojnë sigurimin e Kompanisë, për largimin e tyre jashtë objektit të KUR „Pristina“ Sh.A., në Prishtinë. Përveq sinjalizuesve që nuk është e thënë të jenë vetëm punëtorët e Stacionit, do të kontrollohen edhe regjistrimet e vëzhgimit të kamerave për të pare zbatimin e ligjit.

Neni 7

zbatueshmëria

Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e miratimit nga Bordi Drejtorëve ose Kryeshefi Ekzekutiv.

Personat përgjegjës për hapësirat e specifikuara në nenin 1 të kësaj rregulloreje, dhe në paragrafët 2.2.1, 2.2.2, 2.2.3. dhe 2.2.4. kanë detyrë të:

- a. Duhet të vendosen shenjat “ndalohet pirja e duhanit dhe vlera e dënimit” në bazë të formatit, përmbajtjes, dizajnit, madhësisë, dukshmërisë, vendit dhe të gjitha materialet e tjera të përcaktuara me akt nënligjor nga ministria;
- b. Të largohen të gjitha taketuket nga hapësirat e mbyllura ku ndalohet pirja e duhanit.
- c. Të caktohet një nga zyrtarët të mbikëqyrin respektimin e rregullores mbi ndalimin e pirjes së duhanit,
- d. Duhet të ndërmarrin hapa për të ndaluar personin nga pirja e duhanit, në vendet ku është i ndaluar, duke kërkuar nga personi që të mos pijë duhan, të mos i ofrojnë shërbim, të kërkojnë që personi të largohet nga lokalet apo transporti publik kur është e sigurt që kjo të bëhet, dhe të kontaktojnë organet përkatëse për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit si inspektorët sanitar komunal etj.
- e. organi i punësimit i zbret nga paga neto mujore prej pesëdhjetë (50) euro personit fizik që pi duhan në vend të punës në bazë të raportimit paraprak të personit përgjegjës.

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve

Faton Raçi

